



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor, 2008), të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 10.11.2021, merr këtë

V E N D I M
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR PUNËTORËT E ADMINISTRATËS SË
KOMUNËS SË PRISHTINËS

I.

MIRATOHET Vendimi për ndarjen e mjeteve për punëtorët e administratës së Komunës së Prishtinës.

II.

Shuma e mjeteve të ndara, sipas pikës I të këtij vendimi, është 300 €, për secilin punëtorë të administratës komunale (pako ushqimore), e siguruar nga kategoria "mallra dhe shërbime", nga programi i Administratës së përgjithshme - shërbimet sociale.

III.

Qëllimi i këtij vendimi është dhënia e ndihmës, të cilën Komuna e Prishtinës e ndan për punëtorët e administratës së Komunës së Prishtinës.

IV.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtorja e Financave.

V.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-422/01-245416/21, më 12.11.2021

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
<http://www.prishtina-komuna.org>

